

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Mars, 2023

Samiti për Demokraci: Shqipëria konfirmon vullnetin dhe pjesëmarrjen në angazhimin global antikorrupsion

1-31.03.2023: Lufta kundër korrupsionit vijon të bashkojë vendet në propozimin e iniciativave, konfirmimin e bashkëpunimeve dhe zbatimin e masave. Samiti për Demokraci, si iniciativë e Presidentit të SHBA-ve, vijoi zhvillimin e mbledhjeve antikorrupsion (*cohorti antikorrupsion*) edhe gjatë muajit mars, me zhvillimin e takimeve online të ekspertëve të vendeve të rajonit tonë, zhvillimin e konferencës rajonale të Evropës Jug-Lindore nën drejtimin e Bullgarisë, dhe për të kulmuar me aktivitetin ndërkombëtar në SHBA në 30-31 mars 2023. Në takimet teknike, vendi u përfaqësua nga zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe nga përfaqësues të ILDPKPI. Në takimet e muajit mars, Shqipëria iu bashkua angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare për (I) Forcimi i bashkëpunimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, (II) Zgjerimi i përdorimit të standardeve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor të brendshëm, (III) Forcimi i koordinimit operacional ndërkombëtar dhe (IV) Rritja e shtuar e zbatueshmërisë në nivel kombëtar dhe menaxhimi i aseteve (raste dhe praktika) që vijnë nga krimi. Në konferencën e zhvilluar në datë 21 mars 2023, në kuadër të Samitit për Demokraci në Sofie, Bullgari, u dha një panoramë e kuadrit ligjor dhe rregullator e vendit tonë për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe interesave private si edhe zbatimin e instrumentit të sinjalizimit, kundër korrupsionit. Aktivitetet e Samitit për Demokraci u finalizuan për këtë periudhë të parë tre-mujore të vitit 2023 në takimin ndërkombëtar të zhvilluar në SHBA, me pjesëmarrjen e deleguar të Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Elisa Spiropali. Kryeministri z. Edi Rama, përshëndeti punimet e Samitit me një mesazh të posaçëm, gjithashtu.



Mesazhi i Kryeministrit Rama mund të lexohet në link: <https://kryeministria.al/newsroom/fjala-e-kryeministrit-edi-rama-ne-samitin-e-democracise-organizuar-nga-presidenti-i-shteteve-te-bashkuara-joe-biden/>

Grupi Tematik Teknik Antikorrupsion dakordëson raportin e monitorimit të Planit të Veprimit, 2022

28.03.2023: Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka përfunduar dhe hartuar raportin e monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, për periudhën vjetore, 2022. Raporti është dakordësuar në takimin teknik të datës 28.3.2023 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në planin e veprimit. Ky raport monitorimi jep një informacion mbi progresin për 59 masa dhe 111 aktivitete të planifikuara për zbatim për vitin 2022, që i përket vitit të 3-të të zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion. Nga monitorimi i kryer rezultoi se janë zbatuar plotësisht 38 masa/76 aktivitete, pjesërisht 14 masa/11 aktivitete dhe nuk janë zbatuar 7 masa/24 aktivitete. Shërbimet elektronike vijnë të jenë në pararojë të objektivit strategjik të zbatuar, 1 227 në total, ka filluar deklarimi online i pasurive të zyrtarëve dhe funksionarëve publikë, regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 100 autoritete publike më shumë, të gjitha ministritë kanë hartuar plane integriteti, Policia e Shtetit ka ndërvepruar 405 praktika me Interpolin, 2 740 korrespondenca me Europolin, 77 praktika me rrjetin CARIN. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka dhënë 259 masa administrative dhe depozituar 20 kallëzime penale, janë regjistruar 131 procedime penale me 76 persona në hetim vetëm nga SPAK dhe prokuritë e juridiksionit të zakonshëm kanë regjistruar 262 procedime penale me 201 të pandehur për grupveprat në fushën e korrupsionit. Zbatimi i Strategjisë Antikorrupsion për vitin 2022 llogaritet në masën 76.76%. Draft-raporti final i monitorimit do të diskutohet dhe miratohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion, brenda muajit prill 2023.

Struktura antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë merr masa disiplinore për shkelje të kryera në detyrë

1-31.03.2023: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në bashkëpunim me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, ka administruar dhe kryer veprime inspektimi për 27 raste të reja ankesash dhe denoncimesh për korrupsion, gjatë muajit mars 2023. Veprimtaria e institucioneve si Agjencia Shtetërore e Kadastrës (drejtoritë vendore të saj), Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., janë kontrolluar nga inspektorët dhe koordinatoret antikorrupsion mbështetur në ankesa dhe denoncime të ardhura në rrugë zyrtare me shkrim (21 raste) dhe në adresën elektronike (6 raste). Pas verifikimeve të kryera janë gjetur shkelje dhe janë përfunduar plotësisht 12 raporte përfundimtare, përmes të cilave janë propozuar 4 masa për "largim nga detyra", 46 masa për fillim të ecurisë disiplinore si dhe 44 rekomandime. Të tjera raste hetimi administrativ pranë institucioneve ku është i vendosur Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit, janë në proces, gjithashtu.





Denonconi raste dhe praktika abuzive në: koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Raporti i DASH për Shqipërinë, 2022; mbështet punën e SPAK dhe krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion

20.03.2023: Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka publikuar raportin vjetor për Zbatimin e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut 2022. Për vitin 2022, për Shqipërinë DASH ka vlerësuar me nota pozitive veprimtarinë dhe të dhënat e punës së SPAK si organi kryesor në luftën kundër korrupsionit, duke evidentuar procedimet dhe kërkesat për dënim për funksionarë dhe ish-funksionarë të lartë publikë dhe politikë, si edhe dënimin e tyre nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Raporti i DASH ka evidentuar ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe të dhënat e punës së saj në vitin e parë prej 261 masash administrative dhe raste kallëzimesh penale, si edhe rolin e ILDPKPI për referimin penal të 6 rasteve për ndjekje penale, ku përfshihej një deputet, një prokuror, tre drejtorë në agjencitë qeveritare dhe një administrator në një kompani qeveritare, për akuzat e refuzimit të deklarimit të pasurisë, fshehjen e pasurisë ose falsifikimin e deklaratave të pasurisë, pastrim parash dhe evazion fiskal. Nga ana tjetër, Raporti ka evidentuar probleme me prokurimet publike dhe lirinë e medias, në vend. Raporti sjell në vëmendje edhe pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe eficensën e tij si dhe problematikat për kufizimet në lirinë dhe pavarësinë e medias.

Raporti gjendet i publikuar në link: <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>.



Ministria e Drejtësisë bashkëpunëtoje e ngushtë e projekteve të Këshillit të Evropës në Tiranë

30.03.2023: Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë organizoi takim të parë të Komitetit Drejtues për vitin 2023, pjesë e fazës së III-të të projektit të Instrumentit Horizontal. Të pranishëm në takim ishin përfaqësues në nivel drejtues të institucioneve shqiptare bashkëpunëtoje dhe përfitues të projektit, si Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, Ministria e Brendshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë. Në takim u konfirmua bashkëpunimi me projektin edhe për 4 vitet në vijim dhe u dhanë kontributet për aktivitetet dhe bashkëpunimet konkrete, ku lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të kenë vendin kryesor. Këshilli i Evropës mbetet një prej partnerëve kryesorë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të tjera agjencive shqiptare për lehtësimin në zbatimin e rekomandimeve të GRECO. Ministria e Drejtësisë rislli në vëmendje dhe të interesit të saj për bashkëpunim me Këshillin e Evropës të analizës për instrumentet e integritetit, dhe ofrimin e ekspertizës teknike në fushën e antikorrupsionit. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik i Këshillit të Evropës.



Partneriteti me median si një mënyrë komunikimi me qytetarin në luftën kundër korrupsionit

29.03.2023: Ministria e Drejtësisë ka vendosur ura bashkëpunimi dhe komunikimi me qytetarin nëpërmjet televizionit. Drejtori i Politikave Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, znj. Rovena PREGJA, zhvilloi një bisedë televizive në stacionin RTSH24 për çështje të politikave antikorrupsion, masave dhe objektivave të administratës shqiptare dhe të rolit të tyre në kuadër të procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Pjesëmarrja e Ministrisë së Drejtësisë si institucion drejtues në kapitullin 23: Për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe funksionimin e institucioneve demokratike, bashkëpunimi dhe roli i saj aktiv në informacionet e kapitujve 5, 12, 24 e në kriterin ekonomik, iniciativat themelore të marra në fushën antikorrupsion, bashkëpunimi me qytetarët nëpërmjet medias ishin çështje të cilat u diskutuan. Në këtë bashkëpunim të ri me median, Ministria e Drejtësisë informoi publikun për rolin e saj bashkëpunues në rajon dhe me agjenci të tjera antikorrupsion në kuadër edhe të procesit të Berlinit dhe bashkërendimit të kapaciteteve ligjore dhe teknike.

Ndiqu intervistën televizive të profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100089045846232> dhe
<https://www.linkedin.com/company/88693364>

